# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 01/121**
**Datë: 21.12.2016**

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 21 dhjetor 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkriptit nga mbledhja 117 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 02/121**
**Datë: 21.12.2016**

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 21 dhjetor 2016, nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet Projekt Kodi i Drejtësisë për të Mitur.

2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projekt Kodin nga pika 1. e këtij vendimi t`ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 03/121**
**Datë: 21.12.2016**

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 21 dhjetor 2016, nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet Strategjia për Rregullim më të Mirë për Kosovën 2017-2021.

2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Strategjisë nga pika 1. e këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 04/121**
**Datë: 21.12.2016**

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 21 dhjetor 2016, nxjerr këtë:

# V E N D I M

1. Aprovohet Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave në Kosovë (Sistemi i Planifikimit të Integruar) 2017-2021.

2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Strategjisë nga pika 1. e këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 05/121**
**Datë: 21.12.2016**

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 21 dhjetor 2016, nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa për bartjen e mjeteve nga kategoria ekonomike Mallra dhe Shërbime në kategorinë ekonomike Subvencione dhe Transfere në shumë 60,000.00 (gjashtëdhjetë mijë euro) për projektin për komunikim të procesit të liberalizimit të vizave dhe Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen si në vijim: 20.000 (njëzetmijë euro) nga kategoria buxhetore mallra dhe shërbime kodi i programit 11318 Administrata Qendrore dhe 40.000 (dyzetmijë euro) nga kategoria buxhetore mallra dhe shërbime kodi i programit 11418 Kabineti i Ministrit i Ministrisë së Integrimit Evropian.

3. Obligohet Ministria e Integrimit Evropian dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 06/121**
**Datë: 21.12.2016**

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 21 dhjetor 2016, nxjerr këtë:

# V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për t'iu drejtuar Kuvendit të Republikës së Kosovës për tërheqjen e Projektligjit për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtërishme në Kosovë, dhe i njëjti t'i kthehet Qeverisë së Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin bashkë me kërkesën për tërheqjen e Projektligjit nga pika 1. e këtij vendimi t`ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 07/121**
**Datë: 21.12.2016**

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 21 dhjetor 2016, nxjerr këtë:

# V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Financave për t'i rekomanduar Presidentit të Republikës së Kosovës për autorizimin e Ministrit të Financave për nënshkrimin e Marrëveshjes për Hua për zbatimin e Protokollit Financiar të nënshkruar më 5 korrik 2016, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Francës, ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës, e cila vepron në emër dhe për llogari të Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe NATIXIS, e cila vepron në emër dhe për llogari të Qeverisë së Republikës së Francës.

2. I rekomandohet Presidentit të Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e marrëveshjes nga pika 1. e këtij vendimi, konform afatit të përcaktuar në Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 08/121**
**Datë: 21.12.2016**

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 21 dhjetor 2016, nxjerr këtë:

# V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në shumë prej 150.000 euro (njëqind e pesëdhjetë mijë euro) për mbulimin e kostos për ekspertiza profesionale në çështjen Axos GMBH për kontestin "Privatizimi i PTK-së", që lidhen me vlerësimin e dëmit dhe ekspertiza në fushën e legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar, konventat e zbatueshme në Republikën e Kosovës dhe ligjet e aplikueshme lidhur me investimet.

2. Obligohet Ministria e Financave që mjetet nga pika 1. e këtij vendimi t'i ndanë nga Rezerva e Qeverisë, nën programi Shpenzimet e pa parashikuara me kod 13100 dhe t'i transferojë në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik në kodin organizativ 213, nën-programi Departamenti Ligjor me kod 27200, kategoria ekonomike mallra dhe shërbime.

3. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë